



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.182/5 prot.

Datë 26.02.2024

V E N D I M

Nr. 221 /2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.02.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 185/2024, datë 16.02.2024, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-87877- 11-15-2023, me objekt “Blerje Kompjutera dhe printera për nevoja të Bashkisë Shijak”, me fond limit 2,500,000 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak

Ankimues: Operatori ekonomik “PC STORE” SHPK *me Nipt L01606034A*
Adresa: Rruga e Dibrës, vila 153, kati 1, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Shijak.
Adresa: Lagjja “Erzen” Shijak.

Subjekte të Interesuar: Operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK, *me Nipt. L81506043D* *Adresa: Rr. Idriz Dollaku, L. Ali Demi, Apartamenti 2, shkalla 1, kati i pare, Tiranë.*

Operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK me NIPT *L82428011G. Adresa: Rruga “Fortuzi”, Nr. 66/1, Tiranë.*

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 16.02.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 185/2024 ku vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “PC STORE” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-87877-11-15-2023, me objekt “Blerje Kompjutera dhe printera për nevoja të Bashkisë Shijak”, me fond limit 2,500,000 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 12.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.*
2. ***Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertat, duke skualifikuar operatorët ekonomikë “INSTANT.AL” SHPK “dhe “Blueprint Technologies” SHPK, sipas konstatimeve të këtij vendimi.***
3. *Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e prokurimit dhe në ripublikim të saj, të ketë parasysh konstatimet e këtij vendimi.*
4. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
5. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimes “PC STORE” SHPK.*
6. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
7. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2 Me shkresën nr. 823 prot., datë 23.02.2024, protokolluar me tonën nr. 182/12 prot., datë 26.02.2024, autoriteti kontraktor Bashkia Shijak, informon se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 185/2024, datë 16.02.2024, bashkëlidhur shkresës Formularin e Njoftimit të Anulimit për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-87877-11-15-2023, me objekt “Blerje Kompjutera dhe printera për nevoja të Bashkisë Shijak”, me fond limit 2,500,000 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1 Me shkresën nr. 823 prot., datë 23.02.2024, protokolluar me tonën nr. 182/12 prot., datë 26.02.2024, autoriteti kontraktor Bashkia Shijak, informon se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 185/2024, datë 16.02.2024, bashkëlidhur Formularin e Njoftimit të

Anulimit për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-87877-11-15-2023, me objekt “Blerje Kompjuterë dhe printera për nevoja të Bashkisë Shijak”, me fond limit 2,500,000 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.

II.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit më datë 22.02.2024 por nuk ka kryer rivlerësuar të ofertave në përputhje me vendimin Nr. 185/2024 datë 16.02.2024 të komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi, ku në pikën 2 të dispozitivit të vendimit citohet:

2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertat, duke skualifikuar operatorët ekonomikë “INSTANT.AL” SHPK “dhe “Blueprint Technologies” SHPK, sipas konstatimeve të këtij vendimi.

II.3 Përsa referuar më sipër Autoriteti Kontraktor nuk ka zbatuar Vendimin e KPP-së Nr. 185/2024 datë 16.02.2024.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligji nr. 162/2020 «*Për Prokurimin Publik*», Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-87877-11-15-2023, me objekt “Blerje Kompjuterë dhe printera për nevoja të Bashkisë Shijak”, me fond limit 2,500,000 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

